



## **RELACION PËR PROJEKTVENDIMIN**

### **“PËR PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE, JOPUBLIKE "JUSTICIA", TIRANË”**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Mbyllja e veprimtarisë së shkollës së lartë universitare, jopublike "Justicia", Tiranë, si institucion jopublik i arsimit të lartë. Ky institucion jopublik i arsimit të lartë është hapur me vendimin nr. 671, datë 27.9.2006 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike "Justicia".

#### **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektvendim hartohet në përputhje me programin e Qeverisë Shqiptare, në të cilin nënvizohet nevoja e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë në plotësim të standardeve të mësimi, kushteve të mësimdhënies dhe sigurimit të kualifikimit të stafit akademik.

#### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Shkolla e lartë universitare, jopublike "Justicia", Tiranë licencuar me vendimin nr. 671, datë 27.9.2006 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike "Justicia" ka ushtruar veprimtarinë e tij si institucion privat i arsimit të lartë që në vitin 2006 duke ofruar, në fushën e Drejtësisë, një program studimi “Bachelor”, dy “Master profesional” dhe pesë “Master i shkencave”, si dhe një program studimi “Master i shkencave” në fushën e Mësuesisë.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij kjo shkollë e lartë jopublike ka patur shkelje të ligjshmërisë të cilat u evidentuan edhe gjatë kontrollit të ushtruar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në zbatim të neneve 45, pika 4, e 63, pika 4, të Ligjit nr. 9741, date 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (i shfuqizuar) dhe Urdhrit nr. 106, datë 28.03.2014 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për kryerjen e kontrollit të zbatimit të ligjshmërisë në institucionet publike dhe jopublike të Arsimit të Lartë”. Si rezultat veprimtaria akademike e kësaj shkolle të lartë u pezullua, për një periudhë dy-vjeçare, deri në plotësimin e kriterëve ligjore e nënligjore, të përcaktuara në ligjin për arsimin e lartë dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, sipas vendimit nr. 540,

datë 06.08.2014 të Këshillit të Ministrave “Për pezullimin e veprimtarisë së disa institucioneve private të arsimit të lartë”.

Me qëllim verifikimin në vijimësi të plotësimit të kriterëve ligjore e nënligjore nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të MAS u miratua Urdhri 334, datë 21.08.2014 “Për ngritjen e grupit të punës, për inspektimin dhe verifikimin e situatës lidhur me zbatimin e ligjshmërisë dhe detyrimet e tjera të institucioneve private të arsimit të lartë të pezulluara”, në zbatim të të cilit u realizuan një sërë vizitash inspektimi nga ku rezultoi se ky institucion privat i arsimit të lartë nuk ka arritur të plotësojë kriteret ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 45 i Ligjit nr. 9741, date 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (i shfuqizuar), parashikonte se institucionet private të arsimit të lartë, të cilat nuk respektojnë këtë ligj, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, vendos masa konkrete deri në pezullimin e veprimtarisë së tyre për një periudhë deri në dy vjet (mospranim të studentëve të rinj) apo heqjen e licencës.

Në zbatim të pikës VII të VKM 540, datë 06.08.2014 ku përcaktohet se “Për të gjitha institucionet private të arsimit të lartë, të cilat nuk do të marrin masa për plotësimin e detyrimeve që burojnë nga ligji dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Ministria e Arsimit dhe Sportit i propozon Këshillit të Ministrave, rast pas rasti, heqjen e licencës dhe ndërprerjen përfundimtare të veprimtarisë”, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, paraqet për miratim këtë Projektvendim.

Po ashtu edhe në nenin 7, pika 2, germa “1” të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë i propozon Këshillit të Ministrave mbylljen e veprimtarisë së institucionit të arsimit të lartë, bazuar në raportet e kontrollit të ligjshmërisë, të akreditimit ose auditimit.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektvendimi “Për mbylljen e veprimtarisë së shkollës së lartë universitare, jopublike “Justicia”, Tiranë,” është mbështetur në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, si dhe të germës “1”, të pikës 2 të nenit 7 dhe të nenit 30 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Ky projektvendim nuk lidhet me çështjet e përafrimit të legjislacionit me *acquis communautaire*.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

---

*Relacion shpjegues për Projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për mbylljen e shkollës së lartë universitare, jopublike “Justicia”, Tiranë”.*

Ky projektvendim shfuqizon Vendimin nr. 671, datë 27.9.2006 të Këshillit të Ministrave "Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike "Justicia" dhe përcakton modalitetet e procedurave të mbylljes së këtij institucioni privat të arsimit të lartë. Në zbatim të tij mbyllet e gjithë veprimtaria e shkollës së lartë universitare, jopublike "Justicia", Tiranë", të gjithë njësive përbërëse të tij, si dhe shfuqizohen të gjithë aktet për hapjen e programeve të studimeve të ofruar nga ky institucion.

Për sa më sipër, shkolla e lartë universitare, jopublike "Justicia", Tiranë, mbyllet dhe ka për detyrim:

Mbyllet e veprimtarisë së shkollës së lartë universitare, jopublike "Justicia", Tiranë, për të gjitha programet e studimit të ofruara. Shkolla e lartë universitare, jopublike "Justicia", Tiranë, të përgatitë dosjen për çdo student, me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit të lartë për vazhdimin e studimeve, dhe t'ia vënë atë në dispozicion vetë studentit apo përfaqësuesit ligjor, pa asnjë detyrim financiar shtesë nga ana e tij, brenda datës 16 Shkurt 2018. Shkolla e lartë universitare, jopublike "Justicia", Tiranë të vendosë në dispozicion të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë çdo informacion të kërkuar dhe të vazhdojë të mbajë kontakte me të deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë vendim;

- a. Të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për mbylljen e këtij institucioni jopublik të arsimit të lartë, në zbatim të këtij vendimi, të përballohen nga ana e institucionit jopublik të arsimit të lartë/personit juridik privat që i përfaqëson. Shkolla e lartë universitare, jopublike "Justicia", Tiranë, duhet të kthejë pagesat e kryera nga studentët për pjesën e papërfunduar të programeve përkatëse të studimit, për rastet kur pagesat janë kryer për cikël studimi, si dhe çdo detyrim tjetër të pa përmbushur që mund të kenë ndaj studentit.
- b. Shkolla e lartë universitare, jopublike "Justicia", Tiranë, të arkivojë të gjithë dokumentacionin mësimor, administrativ dhe financiar, në Arkivin e Shtetit në përputhje me kuadrin ligjor mbi arkivat brenda datës 28 Shkurt 2018.
- c. Shkolla e lartë universitare, jopublike "Justicia", Tiranë, nuk duhet të kryejë asnjë lloj veprimi financiar apo lëvizje në llogaritë bankare të institucionit, përveç atyre që kanë lidhje me sa parashikohet në pikën 4 të këtij vendimi. Personi juridik privat, që përfaqëson institucionin privat të arsimit të lartë, të cilit i hiqet licenca, nuk mund të kryejë asnjë lloj ndryshimi të aksioneve apo kuotave të shoqërisë, aseteve të luajtshme e të paluajtshme të saj, para shlyerjes së detyrimeve të parashikuara në këtë vendim.
- d. Vula e shkollës së lartë universitare, jopublike "Justicia", Tiranë, të asgjësohet sipas procedurave të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra Kombëtare e Biznesit, Arkiva e Shtetit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, si dhe shkolla e lartë universitare, jopublike "Justicia", Tiranë.

## VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës dhe Drejtoria e Shërbimeve Juridike në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

**Ministria e Drejtësisë** me shkresën nr. 6455/1 prot., datë 06.12.2017 shprehet se:

- a. Projektvendimit duhet t'i bashkëlidhen konstatimet e kontrollit të ushtruar nga MAS, siç përmendet në relacion. Ky rekomandim është plotësuar.
- b. Në mbështetje të nenit 30/4, të ligjit 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", projektvendimit duhet t'i bashkëlidhen mendimi i Senatit Akademik dhe i Bordit të Administrimit, sikurse parashikohet në paragrafin e dytë të kësaj pike dhe konkretisht "Në rastet kur iniciativa për mbylljen e institucionit ndërmerret nga ministri përgjegjës për arsimin, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit shprehin mendimin brenda një muaji".

Sugjerimi i Ministrisë së Drejtësisë lidhur me këtë pikë nuk mund të gjejë zbatim, pasi Institucioni privat i arsimit të lartë "Justicia", fillimisht është pezulluar me Vendimin nr. 540, datë 06.08.2014 të Këshillit të Ministrave "Për pezullimin e veprimtarisë së disa institucioneve private të arsimit të lartë", në zbatim të neneve 45, pika 4, e 63, pika 4, të Ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (i shfuqizuar). Si rezultat i këtij pezullimi për një periudhë dy-vjeçare, veprimtaria akademike e kësaj shkolle nuk ka funksionuar, për pasojë edhe organet kolegjiale si Senati Akademik etj. nuk kanë funksionuar, ndërsa Bordi i Administrimit nuk është konstituuar fare. Në kushtet kur Bordi i Administrimit nuk ka ekzistuar/funksionuar, Ministria nuk mund të merrte mendimin e këtij organi.

- c. Në lidhje me tekstin e projektvendimit, sugjerohen të rishikohen datat e përmendura në pikat 2 dhe 5, pasi janë të tejkaluara. Kjo u vërejtje u mor parasysh dhe u reflektua në Projektvendim.

**Ministria e Financave**, me shkresat nr. 4570 prot., datë 04.04.2017 dhe nr. 5648 prot., datë 26.04.2017 shprehet se është dakord me këtë projekt-vendim për sa kohë nuk paraqet kosto financiare në buxhet.

## IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projekt akti nuk shoqërohet me implikime financiare.

**PROPOZUESI**  
**MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**

**LINDITA NIKOLLA**